



AKISA

**MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM SHPËTIMIT**

**DHE**

**AUTORITETIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT PËR SIGURINË E**

**OPERIMIT NË AVIACIONIN CIVIL (AKISA)**

**NË RAST**

**INCIDENTI/AKSIDENTI AJROR NË ZONËN/RAJONIN E PËRGJEGJËSISË  
SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Tiranë, 2024



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për  
Sigurinë e Operimit, në Aviacionin Civil

(QKKSH)

(AKISA)

Nr 92 Prot, datë 01, 03 2024

Nr 120 Prot, datë 01, 03, 2024

### MEMORANDUM MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

QENDRËS KOMBËTARE TË KËRKIM SHPËTIMIT

DHE

AUTORITETIT KOMBËTAR TË INVESTIGIMIT PËR SIGURINË E

OPERIMIT NË AVIACIONIN CIVIL

NË RAST

OPERACIONI KËRKIM SHPËTIMI NË HAPËSIRËN E PËRGJEGJËSISË SË  
RSH

### HYRJE

Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi (në vijim referuar si "Memorandumi") është hartuar nga/dhe ndërmjet Qendrës Kombëtare të Kërkim Shpëtimit (QKKSH) në Ministrinë e Mbrotjtes të RSH (në vijim referuar si "QKKSH") dhe Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit, në Aviacionin Civil (në vijim referuar si "AKISA"). Së bashku në vijim referuar si "Palët".

Organizimi i shërbimit të kërkim-shpëtimit dhe detyrimet e Republikës së Shqipërisë për këtë shërbim përcaktohen nga konventat ndërkombëtare dhe aktet ligjore e nënligjore të ratifikuara e miratuara nga autoritetet e vendit tonë.

Autoriteti Kombëtar i Investigimit për sigurinë e operimit në Aviacionin Civil është përgjegjës për investigimet e incidenteve/aksidenteve ajrore brenda hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të operacioneve të kërkim shpëtimit në zonën/rajonin tonë të përgjegjësisë organizohet hetimi/investigimi i incidentit nga **AKISA**, apo dhe në bashkëpunim me institucione të specializuara të vendeve të huaja me qëllim gjetjen e shkakut të aksidentit dhe përcaktimin e përgjegjësive konkrete.

Duke menduar se një Memorandum Mirëkuptimi dhe Bashkëpunimi ndërmjet QKKSH dhe AKISA do të ndihmojë në përcaktimin e saktë të shkaqeve të aksidentit si dhe do të të parandalojnë ngjarje të njëjtë në të ardhmen.

Duke mbajtur parasysh referencat e mëposhtme ligjore:

- Ligji Nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, amenduar nga Ligji Nr. 10484, datë 24.11.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.
- Vendimi Nr. 575, datë 10.08.2011 “Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Avacionit Civil (PKSAC)”.
- Konventa Ndërkombëtare e Avacionit Civil “ICAO” (Organizata Ndërkombëtare e Avacionit Civil), Chikago 1944.
- Dekret i Presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990, “Për aderimin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në Konventën për Avacionin Civil Ndërkombëtar (ICAO) dhe në protokollin për tekstin autentik treguhësh të kësaj konverte.
- ICAO Aneksi 2 “Rregullat e Ajrit”.
- ICAO Aneksi 12 “Kërkim shpëtimi”.
- ICAO Aneks 13 “Investigimet Ajrore”.
- Ligji nr. 96/2020 Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë.
- Ligji Nr.10435, datë 23.06.2011 “Për Shërbimin e Kërkim-Shpëtimit në RSH”.
- Vendimi nr.742, datë 16.10.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.739 datë 03.12.2021, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Investigimit për Sigurinë e Operimit në Avacionin Civil dhe Rregullat për Procesin e Investigimit"
- Plani Kombëtar i kërkim shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe Plani i Veprimit për zbatimin e tij.

#### DUKE QENE SE:

- (i) Palët ndajnë vizionin e mundësimit të forcimit të bashkëpunimit në lidhje me sqarimin përfundimtar të aksidentit dhe marrjen e masave që të mos ndodhë më në të ardhmen me fokus përmirësimin e sigurisë dhe ruajtjen e jetës njerëzore.



AKISA dhe QKKSH, angazhohen plotësisht për zbatimin e kushteve të parashikuara në këtë Memorandum.

Të dyja palët janë të detyruara të koordinojnë ndërmjet tyre për çdo ndryshim të statusit operacional apo të mjeteve të tyre të operimit, të cilat ndikojnë në procedurat e specifikuara në këtë Marrëveshje Teknike.

**PËR KËTË ARSYE**, Palët bien dakord si më poshtë:

**Përkufizime**

Përkufizimet e mëposhtme do të aplikohen në këtë Memorandum:

**“Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit (SAR)”,** eshtë Shërbimi i Kërkim-Shpëtimit, që nënkupton strukturat, sistemet e vrojtimit, personelin dhe mjetet për kryerjen e operacioneve të kërkim-shpëtimit.

**“Kërkim”,**

Një operacion, zakonisht i koordinuar nga një qendër e koordinimit të shpëtimit, duke përdorur personelin dhe mjetet në dispozicion për të gjetur personat në rrezik.

**“Shpëtim”,**

Operacioni i zhvendosjes/i marrjes së personave në rrezik, mbështetja e tyre me nevojat bazë mjekësore ose nevoja të tjera, si dhe dërgimi i tyre në një vend të sigurt.

**“Incident kërkim- shpëtimi”,**

Çdo situatë që kërkon informimin dhe njoftimin e sistemit SAR dhe që mund të kërkojë operacionet SAR dhe hetim të incidentit.

**“Qendra e koordinimit të shpëtimit”,**

Qendra nga e cila një incident SAR kontrollohet dhe koordinohet. Kjo qendër njihet me terma të ndryshëm të tillë, si Qendra e Koordinimit të Shpëtimit, Zyra e Incidenteve Madhore, Zyra e Operacioneve. Për qëllimet e këtij Memorandumi, këto qendër quhet Qendra Kombëtare e Kërkim-Shpëtimi (QKKSH) ose RCC.

**“Koordinimi”,**

Bashkimi i strukturave dhe elementeve SAR, për të siguruar përgjigje efikase të kërkim-shpëtimit. Një njësi SAR duhet gjithmonë të ketë përgjegjësinë e



përgjithshme të koordinimit dhe strukturat e tjera duhet të bashkëpunojnë me këtë njësi për të dhënë përgjigjen më të mirë të mundshme me burimet që kanë dispozicion.

**“Vendngjarje”,**

**“Koordinator në vendngjarje”,**

Zonë kërkimi ose vendi aktual i rrezikut.

Një person i caktuar për të koordinuar operacionet e kërkimit dhe të shpëtimit brenda një zone të specifikuar.

### **Neni 1**

#### **Objekti**

- 1.1 Qëllimi i këtij Memorandumit është njojja e ndërsjelltë e detyrimeve dhe lehtësimi i procedurave të përbashkëta të koordinimit dhe bashkëpunimit në vendngjarje, në rast të një aksident/incidenti SAR.

### **Neni 2**

#### **Kohëzgjatja**


- 2.1 Kohëzgjatja e këtij Memorandumi fillon në datën e nënshkrimit të tij dhe do të zgjasë deri në një afat të pacaktuar, përvèç rasteve kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet Palëve në formë të shkruar.
- 2.2 Memorandumi mund të zgjidhet në çdo kohë nga secila Palë. Zgjidhja e Memorandumit do të jetë efektive në momentin që njëra Palë njofton Palën tjetër përkatesisht në formë të shkruar 3 muaj në advancë në rast se njoftimi në fjalë për zgjidhje të Memorandumit nuk është térhequr/anulluar me miratimin e Palëve përparrë përfundimit të afatit.

### **Neni 3**

#### **Të Drejtat dhe Detyrimet e të dyja Palëve**

##### **3.1 Përgjegjësitë e QKKSH-së**

- Koordinon në nivelin më të lartë kombëtar operacionet e kërkim-shpëtimit në hapësirën tokësore, detare e në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.
- Bashkëpunon dhe koordinon me AKISA në rast të një incidenti brenda zonës/rajonit të përgjegjësisë së RSH, për investigimet e incidenteve/aksidenteve ajrore, në përputhje me legjislatin në RSH.
- Është pikë kombëtare kontakti për operacionet e kërkim-shpëtimit. Ajo bashkëvepron me institucionet shtetërore, entet private dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe përgjigjet për detyrimet kombëtare e ndërkombëtare në fushën e kërkim-shpëtimit në zonat e përgjegjësisë.



- Merr pjesë në seminare trajnuese/konferenca të përbashkëta të organizuara nga AKISA.
- Bën njoftimin e AKISA në rast se zhvillohet operacion SAR në zonën/rajonin e përgjegjësisë së RSH.
- Në raste të incidenteve apo të aksidenteve gjatë operacioneve SAR, QKKSH duhet të njoftojnë menjëherë autoritetet e AKISA-s për të asistuar dhe hetuar për incidentin/aksidentin.
- Bashkëpunon me autoritetet homologe të një shteti tjeter në rast se njoftohet nga AKISA se ka deleguar detyrën e kryerjes së një investigimi një autoriteti të huaj.

### **3.2 Përgjegjësitet e Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit, në Avacionin Civil të Investigimit (AKISA).**

- Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit, në Avacionin Civil është pikë Kombëtare dhe përgjigjet për investigimin e incidenteve/aksidenteve ajrore brenda hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë/ rajonit të përgjegjësisë SAR të RSH.
- Bashkëpunon dhe koordinon për investigimin e incidenteve/aksidenteve në operacionet SAR, të cilat zhvillohen në zonën e përgjegjësisë së RSH.
- Në rast të një incidenti ajror/aeronautik brenda zonës së përgjegjësisë së RSH, koordinimi dhe kontrolli operacional i incidentit ndërmerret nga Autoriteti i Investigimit duke kordinuar me QKKSH.
- Në rast hetimesh të një incidenti ajror/aeronautik , bashkëpunon dhe shkëmben të dhënat e mbledhura me QKKSH.
- Merr pjesë në seminare trajnuese/konferenca të përbashkëta të organizuara nga QKKSH.
- Në rast incidenti ajror/aeronautik në zonën e përgjegjësisë së RSH, mban kontakte me Koordinatorin në vendngjarje.
- Krijon databazë për çdo rast incidenti ajror/aeronautik në zonën e përgjegjësisë të RSH.
- në rast se AKISA delegon detyrën e kryerjes së një investigimi mbi një aksident ose incident të rëndë te një autoriteti homolog i një shteti tjeter, njofton dhe koordinon me QKKSH-në.

### **Neni 4**

#### **Bashkëpunimi**

- 4.1 Palët do të bëjnë përpjekjet më të mira për të bashkëpunuar dhe përbushur të gjitha detyrimet sipas këtij Memorandumi me të gjithë kujdesin e duhur si dhe

në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe detyrimet të cilat rrjedhin nga nënshkrimi i RSH së dokumentave ndërkontaktare.

#### **Neni 5**

##### **Forca Madhore**

- 5.1 As AKISA dhe as QKKSH nuk do të mbajnë përgjegjësi për ndonjë dështim apo vonesë në përbushjen e kushteve të këtij Memorandumi për arsyen e Forcës Madhore. Është rënë dakord në mënyrë specifike se shkaqet e Forcës Madhore janë të pranueshme vetëm për të përcaktuar vonesat me zgjatjen proporcionale të afatit kohor dhe jo si bazë për kompensimin e secilës palë.

#### **Neni 6**

##### **Transferimi i të Drejtave**

- 6.1 Palët, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, nuk do të transferojnë, delegojnë apo kalojnë në ndonjë formë tjetër ndonjë të drejtë apo detyrim sipas këtij Memorandumi ose ndonjë interes apo pretendim përkatës, në tërësi apo pjesërisht, pa miratimin paraprak në formë të shkruar të palëve (AKISA dhe QKKSH), si dhe çdo transferim i kryer pa miratimin paraprak në formë të shkruar si më sipër, do te jetë i pavlefshëm dhe nuk do të ketë fuqi apo efekt.

#### **Neni 7**

##### **Amendamentet**

- 7.1 Memorandumi përbën të gjithë mirëkuptimin e Palëve dhe asnjë kusht, detyrim, mirëkuptim apo marrëveshje e cila ka për qëllim të modifikojë kushtet e këtij Memorandumi nuk do të jetë i detyrueshëm për t'u zbatuar përvèç rasteve kur bëhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga të dyja Palët.

#### **Neni 8**


##### **Memorandumi**

- 8.1 Memorandumi do të interpretohet duke marrë në konsideratë kushtet dhe detyrimet e tij në tërësi. Në çdo rast, çdo klauzolë apo citim i cili mund të krijojë pasiguri duhet të konsiderohet në kontekstin e të gjithë Memorandumit dhe në kontekstin e qëllimeve në bazë të të cilave Palët kanë nënshkruar këtë Memorandum.

#### **Neni 9**

##### **Njoftimet**

- 9.1 Çdo njoftim, aplikim apo komunikim në ndonjë formë tjetër sipas apo në lidhje me këtë Memorandum do të bëhet në formë të shkruar. Përvèç rasteve kur është parashikuar ndryshe në këtë Memorandum, ky njoftim, aplikim apo komunikim



i ndonjë forme tjetër do të konsiderohet të jetë kryer apo bërë në formën e duhur në rastet kur dorëzohet dorazi, me postë apo faksimile tek Pala tjetër tek e cila kërkohet apo lejohet të jepet apo kryhet në adresën e Palës në fjalë të specifikuar më poshtë apo në një adresë të tillë që Pala në fjalë përcakton duke njoftuar Palën tjetër që jep apo bën një njoftim, aplikim apo komunikim të tillë. Komunikimet e përditshme sipas këtij Memorandumi do të bëhen në Shqip dhe në Anglisht.

- 9.2 Një njoftim apo komunikim i një forme tjetër do të bëhen në formë të shkruar dhe do të dorëzohen personalisht ose të dërgohen nëpërmjet postës apo faksimile në adresat e mëposhtme:

#### **QENDRA KOMBËTARE E KËRKIM-SHPËTIMIT**

“Rruga e Dibrës”; Tiranë;

Ndërtesa e Shtabit të Pëgjithshëm të FA;

Mobile: +355 68 804 6638

Tel: +355 42 24 0081

FAX: +355 42 24 0087

E-mail: nsarc@aaf.mil.al / qkksh@mod.gov.al

#### **AUTORITETI KOMBËTAR I INVESTIGIMIT PËR SIGURINË E OPERIMIT, NË AVIACIONIN CIVIL**

Adresa: Rruga: "Princ Vidi", Sheshi Lunxheri 8-42

Tel: +355 47 20 0 500

Fax: +355 47 20 0 002

Mobile : +355 68 30 9 8389

E-mail : [info@akisa.gov.al](mailto:info@akisa.gov.al) / [genc.resuli@akisa.gov.al](mailto:genc.resuli@akisa.gov.al)


#### **Neni 10**

##### **Konfidencialiteti**

Secila Palë do të ndërmarrë të gjitha masat paraprake të përgjegjësisë të nevojshme për të mbrojtur informacionin e marrë sipas këtij Memorandumi nga bërja publike në formë të paautorizuar. Palët bien dakord të mbikëqyrin, në masën e kërkuar sipas legjisacionit të aplikueshëm, rregullat dhe rregulloret e tyre përkatëse, mbrojtjen e informacionit të marrë nga Pala tjetër.

#### **Neni 11**

##### **Dispozita Përfundimtare**



- 11.1 Të gjitha dokumentet, nëse ka, të shkëmbbyera më parë mes tyre, si dhe çdo diskutim dhe marreveshje të bërë më parë dhe të lidhur ndërmjet tyre, të cilat nuk janë përcaktuar në Memorandum, konsiderohen të pavlefshme dhe nuk kanë asnjë efekt ligjor dhe nuk do të merren në asnjë mënyrë në konsideratë në zbatimin e kushteve të këtij Memorandumi.
- 11.2 Ky Memorandum përbën një shprehje përfundimtare në formë të shkruar të të gjitha kushteve dhe detyrimeve të tij dhe është një deklaratë e plotë dhe ekskluzive e këtyre kushteve dhe detyrimeve.
- 11.3 Të gjithë titujt e kapitujve të përdorur në këtë Memorandum janë vetëm për lehtësi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e këtij Memorandumi.
- 11.4 Memorandumi është hartuar në dy kopje originale.
- 11.5 Asnjë ndryshim, plotësim ose modifikim tjetër i këtij Memorandumi nuk do të jetë efektiv nëse nuk është në formë të shkruar, nuk i referohet në mënyrë specifike Memorandumit dhe nuk nënshkruhet nga përfaqesuesit e autorizuar të secilës Palë.
- 11.6 Ky Memorandum është hartuar në gjuhën Shqipe në dy kopje origjinale.

Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e tij përkatëse të nënshkrimit.

Tiranë, më 01 / 03 /2024

<b>Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit</b>  (QKKSH)	<b>Autoriteti Kombtarë i Investigimit për Sigurinë e Operimit, në Avacionin Civil</b>  (AKISA)
<b>(Referuar Autorizimit të Ministritit të Mbrojtjes nr. 1337datë, 27/ 02/2024)</b>	
<b>KRYETARI KOLONEL FIQIRI HOXHA</b>   	<b>DREJTORI I PERGJITHSHEM GENC RESULI</b>  